



Pearson

Çfarë është në të vërtetë një **test i inteligjencës**?

Përse bëhet testi i inteligjencës dhe pse ju duhet të bëni atë? Për të lehtësuar fi llimin, në vazhdim do të shpjegohet pikë së pari se çka është testi i inteligjencës, si realizohet një test i inteligjencës dhe përse është e rëndësishme pjesëmarrja juaj.

Me anë të testit të inteligjencës përcaktohet inteligjenca e fëmijëve dhe të rinjëve në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre. Këtu kryesisht bëhet fjalë për të përcaktuar, cila shkollë është e përshtatshme për ju, në çfarë niveli fi llon kursi i gjuhës tuaj, apo cilat ndihma tjera do të jenë të dobishme për ju. Kjo është një mundësi e mirë për të treguar të gjitha aftësitë e juaja që keni.

Ka shumë fusha të ndryshme të inteligjencës. Dy shembuj janë se sa shpejt dhe mirë mund të zgjidhen detyrat përmendsh, apo sa e keni kujtesën e zhvilluar. Përmes detyrave të ndryshme nga ky test analizohet, se si fushat tuaja të inteligjencës janë të shquara. Kjo zakonisht funksionon kështu: Udhëheqësi i testit ulet në një tavolinë me ty dhe të sqaron detyra të ndryshme. Ti i përpunon këto detyra dhe përpiqesh që të japësh sa më shumë përgjigje të sakta. Udhëheqësi i testit do të evidentoj mbarëvajtjen e testit. Disa shembuj për detyra të testit janë: bashkimi i fi gurave të Puzzle, plotësimi i një shembulli, mbajtja në mend e gjësendeve apo renditja e saktë e një tregimi. Njëkohësisht është krejt normale që ju duhet të mendoni shumë dhe të përqëndrohëni, për të gjetur përgjigjet. Është gjithashtu krejt normale, nëse ju nuk mund të zgjidhni të gjitha detyrat. Më së miri është nëse ju punoni të qetë dhe të përqëndruar.

Është e rëndësishme, që ju mos të fl isni gjatë testit. Testi i inteligjencës në të cilin jeni duke punuar funksionon plotësisht pa folur- e njëjta vlen për të gjitha kulturat dhe gjuhët. Të gjitha detyrat shpjegohen me anë të fotografi ve dhe për përgjigjet shfrytëzoni duart e juaja. Pra mos u frikësoni se nuk do të kuptoni testin për shkak të gjuhës.

Pjesëmarrja juaj në testin e inteligjencës bëhet në mënyrë vullnetare. Nuk ke nevojë ti nënshtrohesh testit nëse nuk dëshiron. Por ky test i inteligjencës ju ndihmon për të marrë mbështetjen dhe ndihmën më të mirë. Prandaj gjithsesi ja vlen që të merrni pjesë me maturi dhe të jepni më të mirën nga vetja.



Meer informatie over onze Wechsler Nonverbal Scale of Ability (WNV-NL) vindt u op www.pearsonclinical.nl/wnv